

Nr. 170 Prot

11.09.03.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
MINISTRI

Nr. 6378 Prot.

Tiranë, më 06.3 2023

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit

Drejtuar: Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK)

Korçë

E nderuar Zj. Drejtore,

Në mbështetje të nenit 14, gurmës "e", të nenit 16, të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"; çështjes me nr. 4.1.12, të Kapitullit IV, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e manualit të procedurave të auditimit të brendshëm", i ndryshuar, bashkëlidhur kësaj shkrese do të gjeni Raportin Përfundimtar të Auditimit të kryer në DRTK Korçë. Raporti i auditimit është shoqëruar me Aneksin nr. 1, të rishikuar - Përmbledhëse e Rekomandimeve dhe Aneksin nr.2 -Observacionet.

Në cilësinë e drejtuesit të DRTK Korçë, ju duhet të plotësoni Planin e Veprimit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara në Aneksin nr. 1, të rishikuar dhe duhet të dërgoni këtë plan veprimi pranë Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Kulturës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e këtij Raporti Përfundimtar.

Një format të sugjeruar të Plan veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve do ta gjeni bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

MINISTRI



ELVA MARGARITI

Model plan veprimi mbi zbatimin e rekomandimeve

Nr. Rek	Rekomandimet	Renditja sipas nivelit	Referenca e paragrafit në raport	Reagimi i menaxhim it të subjektit të audituar	Afati i përcaktuar	Personat përgjegjës për realizimin e rekomandimeve
1	Institucioni të përlogarisë vlerën e penaliteteve si pasojë e mosfurnizimit të paisjeve brenda afatit të përcaktuar në Ftesën për Ofertë dhe më pas të ndjekë të gjitha procedurat për arkëtimin e vlerës së penaltetit të përlogaritur.	I lartë	Çështja IV.1. Sistemi i prokurimeve të fondeve publike; Gjetja nr.4		Menjëherë dhe në vijimësi	
2	Të ushtrohen kontrole efektive parandaluese e zbuluese gjatë marrjes së çdo aktivi në dorëzim, nëpërmjet verifikimit të çdo specifikimi teknik, të afatit të lëvrimin të mallit, duke u shprehur në mënyrë analitike në procesverbalin pëkatës.	I lartë	Çështja IV.1; Gjetja nr.4		Menjëherë dhe në vijimësi	
3	Të krijohet një praktikë e mirë e protokollimit të gjithë dokumenteve të çdo procedure prokurimi, duke filluar nga urdhër prokurimi, procesverbalin për përlogaritjen e fondit limit, përcaktimin e kriterëve të kualifikimit, hartimit të specifikimeve teknike, etj, në vijueshmëri kronologjike. Të administrohen në një dosje të veçantë dokumentet e procedurës së prokurimit, dosje të cilat duhet të arkivohen për llogari të çdo viti ushtrimor.	I mesëm	Çështja IV.1; Gjetja nr.6		Menjëherë dhe në vijimësi	
4	Të mundësohet trajnimi i punonjësve të komisionit të blerjeve të vogla; punonjësit të ngarkuar me detyren e	I mesëm	Çështja IV.1;		Menjëherë dhe	

	sekretari-arkivit.		Gjetja nr.6		në vijimësi	
5	Të rishikohet neni 21, pika 2 dhe pika 3 (germa b, d, f), i Rregullores së Brendshme, i cili duhet të përcaktojë saktë procedurat e rekrutimit nëpërmjet procedurave të konkurimit publik.	I lartë	Çështja IV.2; Sistemi i pagave dhe menaxhimi i burimeve njerëzore; Gjetja nr.1		Brenda muajit prill 2023	
6	Të bëhet shpallja e gjithë vendeve vakante në Buletin e Prokurimeve Publike.	I lartë	Çështja IV.2; Gjetja nr.1		Në vijimësi	
7	Institucioni të lidhë me punonjësit kontratë pune me kohëzgjatje të pacaktuar, sipas përcaktimeve të Kodit të Punës.	I lartë	Çështja IV.2; Gjetja nr.2		Në vijimësi	
8	Të kryhet vlerësimi objektiv vjetor i performancës së punonjësve mbi bazën e objektivave individuale vjetore, si dhe të identifikohen nevojat për trajnime të punonjësve (në rastet kur konstatohen mangësi).	I mesëm	Çështja IV.2; Gjetja nr.3		Në vijimësi	
9	Të arkëtohet shuma 108,000 lekë gjithsej, e përfituar nga paga e grupit sipas vlerës përkatëse, nga punonjësi D.Dh.	I lartë	Çështja IV.2; Gjetja nr.4		Të fillojë menjëherë	
10	Të paguhet nga fondi i pagave shuma 24,080 lekë gjithsej, sipas vlerave përkatëse për punonjësit me arsim të lartë, për vjetërsi pune: Punonjësit E. K t'i paguhet shuma 5,600 lekë; Punonjësit S. B t'i paguhet shuma 10,080 lekë; Punonjësit F. Q t'i paguhet shuma 6,720 lekë; Punonjësit K. D t'i paguhet shuma 1,680 lekë.	I lartë	Çështja IV.2 Gjetja nr.5		Të fillojë menjëherë	
11	Të arkëtohet shuma 15,400 lekë gjithsej nga katër punonjësit	I lartë	Çështja		Të fillojë	

	e institucionit: Punonjësi F. C, të arkëtojë shumën 2,800 lekë; Punonjësi D. Dh, të arkëtojë shumën 3,360 lekë; Punonjëse E. R, të arkëtojë shumën 3,360 lekë; Punonjëse S. N të arkëtojë shumën 5,880 lekë;		IV.2; Gjetja nr.5		menjëherë	
12	Në urdhrin për fillimin e marrëdhënieve financiare të punës të përcaktohen gjithë elementet e pagës së punonjësit, duke përfshirë pagën e grupit dhe vjetërsinë në punë të dokumentuar në librezë pune, e cila duhet ndryshuar me urdhër të brendshëm për çdo vit kalendarik.	I mesëm	Çështja IV.2, Gjetja nr.5		Në çdo rast, në vijimësi.	
13	Të hartohen listë prezencat mujore të punonjësve të administratës dhe mbështetës, të cilat përbëjnë dokument vërtetues për përmbushjen e detyrimeve në lidhje me kohën e punës. Listë prezencat të bashkëlidhen me çdo urdhër shpenzimi me objekt pagat e punonjësve sipas listëpagesave mujore.	I lartë	Çështja IV.2; Gjetja nr.6		Menjëherë	
14	Të përcillet draft Statuti i institucionit pranë Ministrisë së Kulturës, për rishikim dhe miratim. Të hartohet regjistri i riskut të vitit 2023, i cili duhet të integrojë risqet e identifikuar nga çdo sektor.	I lartë	Çështja IV.4. Gjetja nr.1		Draft Statuti të përcillet në Ministrinë e Kulturës brenda muajit Maj 2023. Menjëherë	

Mbyllet me nr.14 (katërbëdhjetë).